



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/42 datë: 31.01.2024

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), neni 17 shkronja (f), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 47 të Ligjit për Ujrat e Kosovës Nr. 04/L-147 "Programi për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave"; Udhëzimit Administrativ 19/2015, për Veprimet e Dëmshme të Ujërave; Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve Strategjike dhe planeve të veprimit. Planin Zhvillimor Komunal i miratuar më 31.10.2009 si dhe Planin Zhvillimor Urban i miratuar më 31.10.2009; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 31.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT STRATEGJIK DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR UJËRA NË KOMUNËN E SHTIMES PËR PERIUdhËN 2024-2028

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2024, e mbajtur më: 31.01.2024, unanimisht miratoi Programin Strategjik dhe Planin e Veprimit për Ujëra në Komunën e Shtimes për periudhën 2024-2028.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitete.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi